

BASHKIA DURRES



**DREJTORIA E SHERBIMEVE
NJESIA E PROJEKTIT DHE INFRASTRUKTURES**

RELACION TEKNIK

**“Rikualifikim Rruga A.Goga nga Sheshi Liria –
Muzeu i Deshmoreve”**



MARS 2017

Relacion teknik

OBJEKTI: RIKUALIFIKIMI RRUGA A.GOGA NGA SHESHI LIRIA- MUZEU I DESHMOREVE

Objekti eshte i pozicionuar ne qender te qytetit, ne rrugen A.Goga nga sheshi Liria deri tek Muzeu i Deshmoreve dhe nga vazhdimi i segmentit te rruges Fetah Bllaca deri ne bashkimin me rrugen A.Goga. Rikualifikimi i kesaj rruge dhe ndertimi i segmentit te ri , per nga vete pozicioni strategjik dhe rendesia arkeologjike, do te ndikoje ne zhvillimin e qytetit, duke i dhene keshtu nje dimension kulturor dhe turistik zones. Gjithashtu Projekti konsiston ne rikualifikimin e saj duke ruajtur gjuhen arkitektonike te objekteve te zbatuara me te cilat lidhet. Ky projekt integrohet me se miri me kontekstin e zones. Projekti parashikon krijimin e dy shesheve te vogla per qytetaret, me stola dhe gjelberim ne ane te Pallatit te Kultures dhe perballe Gjykates, duke ruajtur te njeten njolle te rruges. Ndertimi i segmentit te ri synon te permiresoj qarkullimin automobilistik ne qytet .Projekti synon gjithashtu qe te vere ne pah dhe pasurite arkeologjike te zones duke permirsuar kalimin dhe qendrimin e turisteve te ndryshen prane sitit arkeologjik



Rruga ekzistuese ka afersisht gjeresi 11m, me trotuare mesatarisht 4.5m. Kjo rruge i ka kanalizimet e ujrave te bardha, vetem parashikohet zevendesimi i kapakeve te pusetave ekzistuese me material plastik, duke qene se nje pjese e tyre mungojne dhe ngritja e pusetave ne rruge dhe trotuare. Ndersa kanalizimet e ujrave te zeza nuk jane parashikuar ne projekt pasi ato ekzistuese jane ne gjendje pune. Ndricimi dhe linjat elektrike jane te amortizuara e kane konsum te larte te energjise elektrike. Mungojne linja rezerve per vendosjen e infrastruktures ne te ardhmen (elektrike, linja interneti, kullim ujrat e shiut, etj).

Zgjidhja e gjelberimit do te permiresohet me realizimin e projektit.

Foto nga gjendja ekzistuese



Procurement
Albania



Gjithashtu ne zonen arkeologjike, ku ndodhet tregu bizantin pammaket do te jene prej xhami duke mos pasur keshtu me barriera vizuale dhe duke e zgjeruar pamjen. Ndersa ne pjesen ku rruga A.Goga lidhet me sheshin Liria, kryqezimi do te rregullohet me nje rrethrotullim me diameter 10m dhe korsia e qarkullimit 3.5 m. Gjithashtu duke ju afruar sheshit, per te bere te mundur nje kalim gradual ne te, ne zgjerohemi me trotuare. Trotuari prane Pallatit te Kultures shkon nga 4.3m deri ne 7 m. Gjithashtu do te krijohet nje shesh i vogel me stola per qytetaret, me ndricim, me siperafe te gjelberuara, peme te reja cercis siliquatum dhe newport prunus ceracifera dhe nje rruge kalimi ne ane te Pallatit te Kultures qe lidhet me rrugen Fetah Bllaca duke e bere keshtu te aksesueshme zonen arkeologjike nga sheshi.

Materialet kryesore te perdorura do te jene:

1. Gur trani ne te gjitha trotuaret, te vendosura ne drejtimin sikurse eshte paraqitur ne projekt. Pllakat do te kene trashesi 6cm, me gjeresi nga 20cm deri ne 30 cm dhe gjatesi nga 50cm ne 100 cm.
2. Gur albanera dhe tip i bardhe i prere ne kubike dhe i vendosur ne vendkalimet e kembesoreve dhe guri tip i bardhe ne rrethrotullim.
3. Rampa betoni me cemento te bardhe per kalimin e kembesoreve dhe me panele paralajmeruese te dallueshme per te verbrit ne material polimer dhe komposit.
4. Shtrese asfalti ne rruge dhe korsite e parkimit.

Sa i takon shtresave te tjera, ato jane te detajuara ne projekt dhe preventiv.

Pergjate rruges A.Goga jane pozicionuar 67 poste parkimi per automjete dhe 2 poste parkimi per bicikletat prane institucioneve, Gjykates dhe Prokurorise.

Gjatesia e pergjithshme e rruges A.Goga ne aksin e tij eshte **390** m lineare.

Ndersa gjatesia e pergjithshme e rruges F.Bllaca ne aksin e tij eshte **120** m lineare.

Terreni ka nje pjerresi natyrale e cila vjen nga Pallati Kultures e ulet ne drejtimin e Muzeut te Deshmoreve. Edhe ne projekt pjerresia ekzistuese e rruges do te ruhet.

Planimetria e zones prane Pallatit Kultures



Rruga eshte shoqeruar me kunete betoni nga te dyja anet, me seksion tip 50cm. Gjate gjatesise se tyre jane vendosur sipas planimetrise se projektit dhe pusetave ekzistuese ne vend, pusetat plastike te shkarkimit te ujrave te shiut 70x40cm. Ne projekt nuk do nderhyet ne rrjetin KUZ, por eshte parashikuar nje ngritje e pusetave KUZ ne rast se do te jete nevoja, si pasoje e mbushjes se terrenit.


Punimet qe do te behen per ndertimin e rruges se re lidhese duhet te marin ne konsiderate karakterin shume te ndjeshem arkeologjik te zones ku do te punohet. Ne projekt parashikohet qe ne pjesen e re te rruges germimet te jene minimale ne pjesen me te madhe te gjatesise se rruges kemi te bejme me skarifikim dhe mbushje duke bere te mundur ne kete menyre qe te mos cenohet siti arkeologjigjik. Megjithate eshte parashikuar nje ze ne preventiv per kryerjen e sondazheve arkeologjike rreth 173.5 m³ me synimin studimin e plote te zones.

Per mbrojtjen nga rreshkitjet e mundshme te dherave gjate punimeve ne trotuarin qe ndodhet ne pjesen veriore do te behet lidhja e pllakese se betonit te trotuarit me nje tra beton te armuar me dimensione 30x50 cm traun do te jete gjate gjithe gjatesise se rruges.


Ndricimi ka nje rol te rendesishem ne kete projekt. Jane 3 tipe ndricuesish te perzgjedhur per kete segment, shtyllat e larta, spotet e pemeve dhe trupat ndricues me nje gjatesi prej 500mm (keto elemente ndricimi jane marre te njejte me sheshin Liria per vazhdimin e nje linje kompozicionale).

Gjelberimi eshte parashikuar me peme te reja liquidambar, cercis siliquatum dhe newport prunus ceracifera, dhe do te rimbillen dhe pemet ekzistuese magniola sipas projektit. Ne trotuarin pergjate tregut bizantin dhe gjykates pemet do te rrethohen me kangjella dekorative dhe me lule, te cilat do te jene nga 3 ane kur jane te vendosur buze trotuarit dhe nga 4 ane kur jane te vendosur ne qender te trotuarit.


Detaj i kangjellave te pemeve




Detaj i pemeve ne sheshin perballe gjykates



Detaj i pemeve ne trotuare



Detaj i paneleve paralajmeruese te dallueshme per te verbrit 100x50cm ne material polimer,komposit



Grupi projektimit:

Ark. Adnand Tocila

Ark. Lorela Malshi

Ark. Hysen Cifliku

Ing. Diana Dedja

Ing. Elek Mirela Stefani